1.1. Ky vendim përshkruan masat për të ruajtur dhe, kur është e nevojshme, për të përmirësuar sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Shqipëri.

1.2. Plani i veprimit parandalues i gazit natyror është detyrues për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror dhe zbatohet me përpikëri nga të gjitha organet publike gjatë vendimarrjes së tyre legislative, administrative apo rregullatore, në kuadrin e kompetencave të tyre, përfshirë masat e planit parandalues dhe ofrimin e shërbimeve, sipas standardeve në sektorin e gazit natyror.

1.3. Të gjithë termat e përdorur në këtë plan të veprimit parandalues, që nuk përcaktohen

shprehimisht në këtë plan, përdoren në përputhje me kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

1.4. Plani i veprimit parandalues do të ketë fuqi vepruese në Republikën e Shqipërisë në momentin e operimit të infrastrukturës së gazit natyror, i cili përmbush aktet ligjore në fuqi.

1.5. Në këtë plan, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.5.1. “**Operator i sistemit të transmetimit (OST)**”, personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe ku është e zbatueshme, ndërlidhjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

1.5.2. “**Operator i sistemit të shpërndarjes (OSSH)**”, personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit.

1.5.3. “**Operator i sistemit të depozitimit**”, subjekti, i cili kryen veprimtarinë e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin e hapësirave të depozitimit.

1.5.4. “**Përgjegjës i zonës së tregut (PZT)**”, personi fizik ose juridik i propozuar nga OST-ja, i cili ofron shërbime në një zonë tregtare të nevojshme për të siguruar një trajtim efikas të qasjes në sistemin e gazit në treg. Prokuron ekuilibrin e energjisë për të kompensuar dallimet fizike midis *input*-it dhe *output*-it. Ka informacion rreth gjendjes së furnizimit në zonën e tregut.

1.5.5. “**Përgjegjësi i grupit balancues (PGB)**”, personi fizik ose juridik, që i përgjigjet palës përgjegjëse për zonën e tregut dhe i ngarkuar për trajtimin e grupit balancues. Emëron OST-në dhe PZT-në në emër të KT-së së saj, përgjegjës për menaxhimin e grupeve balancuese, të detyruar të sigurojnë disponueshmërinë e sasive dhe ekuilibrin e grupeve balancuese brenda zonës së tregut;



1.5.6. “**Rregullore e sigurisë së furnizimit**” përfshin sigurinë e furnizimit të gazit natyror dhe të sigurisë teknike.

II. PËRMBAJTJA E PLANIT TË VEPRIMIT PARANDALUES

2.1. Përmbajtja e planit të veprimit parandalues është përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si edhe në rregulloren (BE) 2017/1938 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 25 tetor 2017, rreth masave për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz. Sipas kësaj dispozite, plani e veprimit parandalues duhet të përmbajë:

i. rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe një përmbledhje të skenarëve të shqyrtuar;

ii. përcaktimin e klientëve të mbrojtur;

iii. masat, vëllimet dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur standardet e infrastrukturës dhe furnizimit me gaz, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, masën në të cilën masat e kërkesës mund të kompensojnë mjaftueshëm, në kohën e duhur, një ndërprerje të furnizimit me gaz;

iv. detyrimet e vendosura ndaj ndërmarrjeve të gazit natyror, shoqërive të energjisë elektrike, sipas rastit dhe organeve të tjera përkatëse, që mund të kenë ndikim në sigurinë e furnizimit me gaz, siç janë detyrimet për funksionimin e sigurt të sistemit të gazit;

v. masa të tjera parandaluese të përcaktuara për të adresuar rreziqet e identifikuara në vlerësimin e rrezikut, të tilla si ato që lidhen me nevojën për të përmirësuar ndërlidhjet ndërmjet shteteve fqinje, për të përmirësuar më tej efikasitetin e energjisë, për të reduktuar kërkesën për gaz dhe mundësinë për të diversifikuar rrugët dhe burimet e furnizimit me gaz dhe shfrytëzimin rajonal të kapaciteteve ekzistuese të depozitimit dhe GNL-së, nëse është e përshtatshme, në mënyrë që të ruhet furnizimi me gaz për të gjithë klientët, sa më shumë që të jetë e mundur;

vi. informacion për ndikimin ekonomik, efektivitetin dhe efikasitetin e masave të përfshira në plan, duke përfshirë detyrimet që kanë shërbimet publike, në lidhje me sigurinë e furnizimit me gaz;

vii. një përshkrim të efekteve të masave të përfshira në plan në funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë, si dhe të tregjeve kombëtare, duke përfshirë detyrimet që kanë shërbimet publike, në lidhje me sigurinë e furnizimit me gaz;

viii. një përshkrim të ndikimit të masave në mjedis dhe te klientët;

ix. mekanizmat që do të përdoren për bashkëpunim me shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë mekanizmat për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të veprimit parandalues dhe planeve emergjente;

x. informacion për ndërlidhjet dhe infrastrukturën ekzistuese e të ardhshme, duke përfshirë ato që ofrojnë akses në tregun e brendshëm, flukset ndërkufitare, aksesin ndërkufitar në objektet e magazinimit dhe GNL-së dhe kapacitetin me dy drejtime, veçanërisht në rast të një emergjence.

2.2. Plani i veprimit parandalues për gazin natyror do të përditësohet çdo katër vjet ose më shpesh në rastet kur siguria e furnizimit me gaz vendoset në rrezik ose me kërkesë të sekretariatit të komunitetit të energjisë.

III. PËRSHTATJA ME STANDARDET E FURNIZIMIT

3.1. Klientët e mbrojtur

Termi “klientë të mbrojtur” është përcaktuar në nenin 4, pika 38, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar. Në përputhje me rregulloren (BE) 2017/1938, “klient i mbrojtur” i ndërmarrjeve të gazit do të thotë një klient i furnizuar drejtpërdrejt nga:

i. përdoruesit fundorë në rrjetin e shpërndarjes së gazit, që marrin gaz direkt nga shoqëritë e gazit dhe që u nënshtrohen profileve të standardizuara të ngarkesës ose përdoruesit fundor në rrjetin e shpërndarjes së gazit, marrin gaz direkt nga shoqëritë e gazit dhe dërgojnë gaz për qëllime ngrohjeje për familjet, në masën që gazi nevojitet për këtë qëllim;

ii. shërbimet sociale thelbësore, sipas kuptimit të ligjit dhe rrjetit të transmetimit të gazit;

iii. sistemet e ngrohjes qendrore në masën që ato përdoren për të shpërndarë ngrohjen te klientët brenda kuptimit të nënndarjeve “i” dhe “ii”, pasi ato janë të lidhura në një rrjet të shpërndarjes ose të transmetimit të gazit dhe nuk janë në gjendje të kalojnë në një lëndë djegëse tjetër, si dhe në masën që ky gaz nevojitet për qëllime ngrohjeje.

3.2. Vëllimet dhe kapacitetet e gazit

3.2.1. Kërkesat në përputhje me nenin 6.1.a) të rregullores (BE) 2017/1938

Në bazë të nenit 6.1.a) të rregullores (BE) 2017/1938, standardi i furnizimit kërkon që



ndërmarrjet e gazit të ruajnë furnizimin e “klientëve të mbrojtur” edhe në rastin e konsumit veçanërisht të lartë të gazit e të ndërmerren masat e duhura parandaluese. Për këtë janë përshkruar tre skenarë:

- Rasti a: Temperaturat ekstreme gjatë një periudhe piku 7-ditor, që ndodhin me një probabilitet statistikor prej një herë në 20 vjet;

- Rasti b: Çdo periudhë prej të paktën 30 ditësh të kërkesës jashtëzakonisht të lartë për gaz, që ndodh me një probabilitet statistikor një herë në 20 vjet;

- Rasti c: Për një periudhë 30-ditore, në rast të prishjes së infrastrukturës së vetme më të madhe të gazit, referuar temperaturave nën mesatare gjatë periudhës dimërore.

3.3. Përputhshmëria me standardin e furnizimit

Kërkesat për plotësimin e kushteve sipas akteve ligjore në fuqi, konkretisht, në ligjin nr. 102/2015, për sektorin e gazit natyror, dhe në rregulloren (BE) 2017/1938 të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, janë të detyrueshme për të gjitha shoqëritë që operojnë në Shqipëri, për të përmbushur standardin e furnizimit me gaz.

IV. MASAT PARANDALUESE

4.1. Masa parandaluese të programuara për të adresuar rreziqet e identifikuara në vlerësimin e rrezikut, siç janë ato që lidhen me nevojën:

i. për të forcuar ndërlidhjet midis vendeve palë të komunitetit të energjisë;

ii. për të përmirësuar më tej efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar kërkesën për gaz;

iii. për të diversifikuar rrugët e gazit, burimet e furnizimit me gaz dhe përdorimin rajonal të kapaciteteve ekzistuese të depozitimit dhe të GNL-së, si dhe për të ruajtur sa më shumë furnizim me gaz sa të jetë e mundur për të gjithë klientët.

4.2. Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis të gjitha palëve dhe zbatimi në kohë i masave përkatëse është i nevojshëm jo vetëm për ruajtjen, por aty ku është e domosdoshme dhe e dobishme në aspektin makroekonomik, për të rritur më tej qëndrueshmërinë ndaj krizave të furnizimit dhe, në këtë mënyrë, për të reduktuar më tej mundësitë e krizave të furnizimit, të cilat janë:

i. forcimi i bashkëpunimit në funksionimin e rrjetit;

ii. zgjerimi i rrjetit;

iii. ngritja e mjeteve shtesë ndërldhëse ndërkufitare me aftësi të rrjedhës së kundërt;

iv. zgjerimi i objekteve të magazinimit;

v. bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të energjisë elektrike dhe gazit;

vi. përmirësime në bazën e të dhënave.

4.3. Përgjegjësitë e shoqërive të gazit

Detyrime të përgjithshme ekonomike janë vendosur për të gjitha shoqëritë e gazit që operojnë në Shqipëri, në lidhje me furnizimin e konsumatorëve dhe veçanërisht të konsumatorëve të mbrojtur.

Mbështetur në kuadrin ligjor për gazin natyror, ndërmarrjet e gazit kanë për detyrë:

- të sigurojnë një furnizim me gaz për publikun e gjerë, i cili duhet të jetë i sigurt, me kosto të ulët, miqësor ndaj konsumatorit, efikas dhe i pajtueshëm me mjedisin;

- të sigurojnë stabilitetin e rrjetit;

- të jenë përgjegjëse për përmbushjen e standardit të furnizimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Në veçanti, ata duhet të furnizojnë kategorinë e “klientëve të mbrojtur” me gaz, edhe në rastin e një ndërprerjeje të pjesshme të furnizimit me gaz ose në rastin e kërkesës jashtëzakonisht të lartë për gaz, “për sa kohë që është e arsyeshme në aspektin ekonomik, furnizimi me gaz”;

- të jenë përgjegjëse për furnizimin e publikut me gaz. Shoqëritë e gazit i kryejnë këto detyra me përgjegjësinë e tyre;

- të përdorin instrumentet e bazuara në treg, për të përmbushur detyrimet e furnizimit; në varësi të rolit të tregut, kjo përfshin masa si diversifikimi i furnizimeve me gaz dhe i rrugëve të furnizimit me gaz, investimet në infrastrukturë dhe mbajtja e përdorimi i sasive të gazit të magazinuar.

Operatorët e sistemit vendës janë përgjegjës për funksionimin e sigurt dhe zgjerimin e nevojshëm të rrjetit.

OST-ja dhe OSSH-ja duhet të marrin parasysh nevojën për të siguruar furnizimin për klientët e mbrojtur, nëpërmjet sistemeve të sigurta dhe të besueshme.

Në rastin e pengesave të furnizimit me gaz, funksionimi i sistemit, dhënia dhe planifikimi i kapaciteteve, duke përfshirë kapacitetet tranzitore, duhet të ndërmerren në një mënyrë që ruan sigurinë e furnizimit të konsumatorëve të mbrojtur për aq kohë sa është e mundur.

4.4. Bashkëpunimi midis operatorëve të sistemit

Operatorët e sistemit vendës duhet të angazhohen në koordinim të ngushtë me operatorët



e sistemit të vendeve të tjera ndërkohë që plotësojnë detyrimet e furnizimit:

i. Dhënia e informacionit:

Për të siguruar furnizimin me gaz, OST-ja/OSSH-ja janë të detyruara, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, t'i japin informacionin e nevojshëm çdo operatori tjetër të sistemeve të furnizimit me gaz, i cili është i lidhur me sistemin e tij. Detyrimi vlen edhe për operatorët e magazinimit.

ii. Plani i zhvillimit të rrjetit (PZHR):

Sipas seksionit, u kërkohet të hartojnë PZHR-në çdo dy vjet. Në plan konstatojnë bashkërisht nevojën për infrastrukturë në dhjetë vitet e ardhshme. OST-ja vendos në dispozicion informacionin e nevojshëm për këtë. Pas miratimit nga ERE, ky plan është i detyrueshëm për OST-në.

iii. Kapacitetet për flukset e kundërta:

OST-ja është përgjegjëse për krijimin e kapaciteteve të përhershme me dy drejtime në të gjithë ndërlidhësit ndërkufitarë, në përputhje me përcaktimet ligjore. Për këtë qëllim, do të bashkëpunojnë me OST-të fqinje.

4.5. Përgjegjësitë e autoriteteve

4.5.1. Përgjegjësitë e autoriteteve në përputhje me rregulloren (BE) 2017/1938 e sigurisë së furnizimit me gaz natyror, janë përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

4.5.2. Autoriteti kompetent për sigurimin e zbatimit të masave të përcaktuara është ministria përgjegjëse për energjinë, e cila është përgjegjëse për konceptin e planit të veprimit parandalues dhe të emergjencave, kuadrin ligjor të përcaktuar më sipër, si dhe për përcaktimin e detyrave e përgjegjësi të agjencive dhe personave të përfshirë. Kjo ministri është, gjithashtu, përgjegjëse për përmbushjen e standardeve të infrastrukturës.

4.5.3. Organet kompetente do të mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve të vendosura ndaj shoqërive ose shoqatave të ndërmarrjeve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe urdhrat e miratuar në bazë të përcaktimeve ligjore.

4.6. Detyrimet e komunitetit në lidhje me sigurinë e furnizimit

4.6.1. Ministria përgjegjëse për energjinë është pika qendrore e kontaktit për shtetet partnere evropiane dhe komunitetin e energjisë, si dhe siguron rrjedhën e informacionit në këto pika në kontekstin e konsultimeve. Parandalimi i krizës

është në parim një përgjegjësi kombëtare, ndërsa konsultimet marrin parasysh çështjet ndërkufitare.

4.6.2. Për të ruajtur sigurinë e furnizimit në rast krize, paraprakisht Shqipëria angazhohet në kryerjen e një koordinim ndërkufitar me vendet fqinje.

4.7. Bashkëpunimi mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë

4.7.1. Bashkëpunimi parashikon që të gjitha format e komunikimit të përdoren për bashkëpunimin brenda grupit të rrezikut. Për sa i përket parandalimit të krizave, është e rëndësishme që të ketë kontakte me ekspertë, në mënyrë që të shmanget dëmi, duke u angazhuar në një shkëmbim të hershëm dhe transparent të informacionit.

4.7.2. Parandalimi i krizës është në parim një përgjegjësi kombëtare; konsultimet marrin parasysh çështjet ndërkufitare. Për të ruajtur sigurinë e furnizimit në rast krize, është e nevojshme që OST-ja të koordinohet paraprakisht me OST-të përkatëse në vendet fqinje.

4.7.3. OST-ja përfshin, gjithashtu, operatorët fqinjë të sistemit ndërkufitar në konsideratat e tyre në lidhje me zgjerimin e infrastrukturës në kontekstin e konsultimeve mbi planin e zhvillimit të rrjetit.

VENDIM

Nr. 719, datë 13.12.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; dhe të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion



të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, në vlerën prej 133 968 072.50 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 133 968 072.50 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e

pronësisë origjinale ose dublikat, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Tiranë.

7. Shpronësimi fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Bashkia Tiranë kryen likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit.

10. Bashkia Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë të pasurive, pronë private, të shpronësuar, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM DHE/OSE KOMPENSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË			Vlera totale (leke) Kompensim në vlerë	Konfirmuar/shënime	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas	Lloji i pas.	Sip. truall/arë totale m²	Shpronësim tokë "truall"					
								Sip. e prekur (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)			
PRONË PRIVATE													
1	Nysret Sait	Haki	Haxhija Fani	8320	1/136	Truall	2,336.0	2,336.0	22,985.0	53,692,960.00	53,692,960.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
2	Sait	Haki	Fani	8320	1/162	Truall	1,712.0	1,712.0	22,985.0	39,350,320.00	39,350,320.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
4	Diana Robert Genc Juliana	Aleksandër Aleksandër	Hoxha Dako Ruli Mosi	8320	1/610	Truall	1,392.0	1,392.0	22,985.0	31,995,120.00	31,995,120.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	NR. 00003519, 18.04.2019, emërtimi: INSK.2245, datë 27.12.2007.
5	Jani	Syrja	Gjikopulli	8320	1/134	Truall	1,100.0	184.00	22,985.0	4,229,240.00	4,229,240.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	
6	Sofo	Mano	Limaj	8320	1/637	Truall	300.0	49.5	22,985.0	1,137,757.50	1,137,757.50	Konfirmuar nga ASHK-ja	Bllokohet në favor të NBG sh.a.
7	Sofo	Mano	Limaj	8320	1/638	Truall	1,522.0	155.00	22,985.0	3,562,675.00	3,562,675.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	Pasuria bllokohet në favor të Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. për shumën 125,000 euro
Vlera totale (lekë) Kompensim në vlerë							8,362.0	5,828.5			133,968,072.50		



VENDIM

Nr. 720, datë 13.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 354, DATË 16.6.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR
PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E RRUGËS PORTI I
JAHTEVE–BYPASS ORIKUM–DUKAT
(URA E SHËN ELIZËS)”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 354 datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë”, “truall”, “ndërtesë” dhe “pemëtoje”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 23 128 876,3 (njëzet e tre milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekësh.”.

b) Në pikën 4 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Vlera “20 838 377.3 (njëzet milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tre) lekë” zëvendësohet me “23 128 876,3 (njëzet e tre milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tre) lekë”;

ii. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) vlera prej 2 290 499 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Nr.	PRONARI			TE DHENAT KADASTRALE (SIPAS KARTELES SE PASURISE)				VLERESIMET PER SHPRONESIM SIPAS LLOJIT TE PASURISE													Vlera totale (lekë)	Shënime																										
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. Totale (m²)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "trull"					Shpronësim tokë "pyll"			Ndërtëse banimi (shërb)				Ndërtëse jo banimi		Ndërtëse total																							
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. ndërt. konf. ZVRPP (m²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ZVRPP-ë (l/m²)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP-ja (m²)			Vlera sipas preventivit (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP-ja (m²)																								
1	EVELINA		CARA	2832	119/13	Arë	4000.9	163	204	33,252.00														33,252.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.																							
2	IRMA		SKENDERI	2832	119/14	Arë	5736.12	252	204	51,408.00														51,408.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.																							
3	AFRIDA		MEHILLI	2832	119/17	Arë	1912.89	69.2	204	14,116.80														14,116.80	Konfirmuar nga ASHK-ja.																							
	AGRON		MEHILLI																																													
	DIJAVER		MEHILLI																																													
	DRIJA		MEHILLI																																													
	ERMDRA		MEHILLI																																													
	EVELINA		CARA																																													
	FIORINA		MEHILLI																																													
	GENIS		MEHILLI																																													
	GEZIM		MEHILLI																																													
	IRMA		SKENDERI																																													
	ISMET		MEHILLI																																													
	MIROSHI		MEHILLI																																													
	MITHTAT		MEHILLI																																													
	MJAFTIME		MEHILLI																																													
4	FIORINA		MEHILLI	2832	119/20	Arë	1390.68	120.6	204	24,602.40													24,602.40	Konfirmuar nga ASHK-ja.																								
5	MJAFTIME		MEHILLI	2832	119/21	Arë	1392.61	126.5	204	25,806.00													25,806.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.																								
6	MIROSHI		MEHILLI	2832	119/22	Arë	1392.39	127.1	204	25,928.40													25,928.40	Konfirmuar nga ASHK-ja.																								
7	SULETANA		MEHILLI	2832	119/23	Arë	1389.86	140.3	204	28,621.20													28,621.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.																								
8	BEKTASH		KALAJ	2832	184/4	Pernëtorë	11571.74	653.3	204	133,273.20														133,273.20	Konfirmuar nga ASHK-ja (bazuar në shërbimet e Bashkisë) Vlojë me nr. 13768/1 prot., datë 10.11.2023, sqarimë se mbi sipërfaqen e shpronësuar nuk ka të njëjllë dështime. Shpronësimi bëhet për sipërfaqen e tokës "arë".																							
	ELISA		KALAJ																																													
	ENIDA		KALAJ																																													
	HANKO		BLUSHAJ																																													
	KAPO		KALAJ																																													
	LAURETA	MUÇAJ	KALAJ																																													
	LEPTER		BLUSHAJ																																													
	LUIZA	SHAHAJ	KALAJ																																													
	MEMEDI		KALAJ																																													
	MEZE		BLUSHAJ																																													
	MUGO		BLUSHAJ																																													
	MURAT		KALAJ																																													
	NURO		BLUSHAJ																																													
	PIRO		KALAJ																																													
9	SALJE	COBAJ	KALAJ	2832	186/21	Pernëtorë	6644.01	116.5	204	23,766.00														23,766.00	Konfirmuar nga ASHK-ja (bazuar në shërbimet e Bashkisë) Vlojë me nr. 13768/1 prot., datë 10.11.2023, sqarimë se mbi sipërfaqen e shpronësuar nuk ka të njëjllë dështime. Shpronësimi bëhet për sipërfaqen e tokës "arë".																							
	SEFFRE		KALAJ																																													
	VLADIMIR		KALAJ																																													
	BEKTASH		KALAJ																																													
	ELISA		KALAJ																																													
	ENIDA		KALAJ																																													
	HANKO		BLUSHAJ																																													
	KAPO		KALAJ																																													
	LAURETA	KALAJ	MUÇAJ																																													
	LEPTER		BLUSHAJ																																													
	LUIZA		KALAJSHAHAJ																																													
	MEMEDI		KALAJ																																													
	MEZE		BLUSHAJ																																													
	MUGO		BLUSHAJ																																													
10	MURAT		KALAJ	2832	188/14	Arë	3088	60	204	12,240.00														12,240.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.																							
	NURO		BLUSHAJ																																													
	PIRO		KALAJ																																													
	SALJE	COBAJ	KALAJ																																													
	SEFFRE		KALAJ																																													
	VLADIMIR		KALAJ																																													
	SHANIKO		GIOLIKAJ																																													
	11	MERRI																								KURTI	2832	188/15	Arë	713.59	49.4	204	10,077.60													10,077.60	Konfirmuar nga ASHK-ja.	
	12	AFRIM																								KARAGIOZI	2832	188/4	Arë	6611.03	158.6	204	32,354.40														32,354.40	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shënime: seksioni D i kartelës "ka 2 ndërtime pa leje, urdhërkufëzim" e, në këtë pajisje ka dy objekte me sipërfaqe: 22 m² dhe sip.≈ 32 m² 3934 (sipas gjurmës, këto ndërtesa nuk përcen nga shpronësimi).
		ALMA																								BRKCU																						
ANILA			ALITE																																													
EDJARA		ALI	ALITE																																													
ENGJELL			DELVINA																																													
ERMIRA			GJRI																																													
FADIL			ALITE																																													
FTSNIKE			KACANI																																													
GEZIM			KARAGIOZI																																													
HALIM			KARAGIOZI																																													
HYSEN			KARAGIOZI																																													
ILIR			KARAGIOZI																																													
KUTJIM			KARAGIOZI																																													
LIJANA		HASAN	KARAGIOZI																																													

[illegible]

**VENDIM****Nr. 722, datë 13.12.2023****PËR DISA TË DREJTA TË
PUNONJËSVE TË AGJENCISË SË
MBIKËQYRJES POLICORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 62, pika 4, 66, pika 6, dhe 70, pikat 1, shkronjat “b”, “c” dhe “d”, dhe 3, të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (në vijim “punonjësi i Agjencisë”), i emëruar në detyrë, i cili me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë transferohet ose emërohet, në përputhje me funksionin që mban, brenda strukturave qendrore dhe vendore të Agjencisë, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, si më poshtë vijon:

a) nga 36 km deri 60 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/muaj;

b) nga 61 km deri 100 km, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj;

c) nga 101 km deri 150 km, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë/muaj;

ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë/muaj;

d) mbi 200 km, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të Agjencisë, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin që përkon me juridiksionin e njësisë strukturore të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ku punonjësi është caktuar.

2. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore paraqet në strukturën përgjegjëse të burimeve njerëzore dokumentacionin e poshtë-shënuar:

a) kërkesë me shkrim, ku është i punësuar si punonjës i Agjencisë;

b) fotokopje të kartës së identitetit, certifikatën e gjendjes familjare;

c) vërtetim nga organi i qeverisjes vendore, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të Agjencisë, pavarësisht nga gjendja civile;

ç) vërtetim pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi i agjencisë ka banesë në juridiksionin ku është transferuar;

d) vërtetim pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nëse punonjësi i Agjencisë ka aplikuar për legalizim banese në juridiksionin ku është transferuar.

3. Kur punonjësi i Agjencisë transferohet ose emërohet në detyrë në punë jashtë vendbanimit të tij, dhe për këtë shkak, bashkëshorti ndërpret marrëdhëniet e punës, bashkëshorti ka të drejtë të përfitojë një pagë mujore, në rast se nuk mund të punësohet në vendin e transferimit ose të emërimit në punonjësit të Agjencisë. Paga mujore përfitohet deri në datën e punësimit të bashkëshortit, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet. Paga mujore është në masën 100 (njëqind) % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por, në çdo rast, jo më shumë se 150 (njëqind e pesëdhjetë) % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Paga mujore, sipas pikës 3 të këtij vendimi, rritet me të njëjtën masë, si dhe masa e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

5. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, punonjësi paraqet në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore dokumentacionin e poshtë-shënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealogjetet e plota, drejtuar strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore, në të cilën përcaktohen:

i. urdhri i transferimit;

ii. data e transferimit;

iii. arsyetja e transferimit;

iv. adresa ku ka banuar deri në momentin e transferimit;

v. adresa aktuale ku banon pas transferimit;

vi. qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkak i largimit nga puna.

b) Për hartimin dhe miratimin e procedurës, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore kërkon nga punonjësi dokumentacionin, si më poshtë vijon:



i. vërtetim të pagës mesatare mujore të vitit të fundit kalendarik të punës për pagesën e marrë nga bashkëshortja/bashkëshorti;

ii. vërtetim nga sigurimet shoqërore për kontributet e derdhura nga bashkëshorti/bashkëshortja për periudhën e punësimit;

iii. librezën e punës së bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të transferimit të bashkëshortes/it;

iv. vërtetim nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkuar i papunë dhe nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo 3 (tre) muaj në njësinë përgjegjëse të burimeve njerëzore;

v. kontratën e qirasë së banesës ku punonjësi është i transferuar;

vi. fotokopje të kartës së identitetit, certifikatën e gjendjes civile familjare;

vii. vërtetim nga njësia administrative/bashkiake / bashkia, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të Agjencisë, pavarësisht nga gjendja civile.

6. Vjetërsia në punë e bashkëshortes/it konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, për të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore, e pasqyruar në dokumentacion sipas procedurave për regjistrimin dhe evidentimin e kontributeve, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhave të trajtimit me pagesë papunësie.

7. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të Agjencisë llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kontributi në degën e sigurimeve të pensioneve derdhet nga institucioni, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore mbi bazën e pagesës së përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

8. Punonjësi i Agjencisë për rezultate të larta në punë, gjatë kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në realizimin e veprimtarive të Agjencisë, si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit, përfiton shpërblim deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit. Ky shpërblim përballohet nga

fondi i pagave të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe mund të jepet përgjatë të gjithë vitit kalendarik.

9. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 7 të këtij vendimi, drejtori i drejtorisë qendrore apo rajonale në Agjenci paraqet në strukturën përgjegjëse të burimeve njerëzore, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, propozimin për shpërblim për punonjësin, duke e shoqëruar me relacionin për rezultatet konkrete të arritura. Pas shqyrtimit të propozimit dhe të verifikimeve, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet një vendimi të arsyetuar, miraton ose jo përfitimin e këtij shpërblimi.

10. Në rast sëmundjeje të rëndë apo fatkeqësie familjare, punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore përfiton ndihmë financiare në masën e 1 (një) page mujore (pagën më të lartë mujore të nivelit të ulët drejtues).

11. Për përfitimin e ndihmës financiare, sipas pikës 9 të këtij vendimi, punonjësi i Agjencisë paraqet në strukturën përgjegjëse të burimeve njerëzore, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Për sëmundje të rëndë:

i. raport mjekoligjor nga spitali ku është shtruar;

ii. kopje të kartelës ekzaminuese të shtrimit në spital.

b) Në rast të vdekjes së një anëtarit të familjes së tij (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët):

i. certifikatë familjare;

ii. certifikatë vdekjeje të familjarit.

12. Punonjësi i Agjencisë gëzon të drejtën e pushimit vjetor të pagueshëm, si më poshtë vijon:

a) 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të lartë drejtues;

b) 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues;

c) 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të ulët drejtues;

ç) 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit ekzekutiv.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

14. Vendimi nr. 776, datë 19.11.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, shfuqizohet.



15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 723, datë 13.12.2023

PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE
KREDIVE TË PAKTHYERA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (në vijim “Agjencia”) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i Agjencisë përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për financat.

3. Agjencia ka për mision sigurimin e menaxhimit të skemave të veçanta të garancive të huas, si dhe trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË
AGJENCISË PËR MENAXHIMIN E GARAN-
CIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

Agjencia ka këto përgjegjësi:

a) organizimin e punës për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive shtetërore të huas;

b) organizimin e punës për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave;

c) organizimin e punës për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre;

ç) organizimin e punës për trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria “INSIG” sh.a., para privatizimit të saj.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
AGJENCISË

1. Agjencia e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia organizohet në nivel qendror.

2. Me qëllim përmbushjen e misionit, të funksioneve dhe të përgjegjësiwe funksionale të saj, Agjencia:

a) mbledh detyrimet e huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies e nënhuazimit të fondeve;

b) verifikon dhe konfirmon përmbushjen e kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare;

c) administron informacionin dhe dokumentacionin e skemave të veçanta të garancisë;

ç) monitoron shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë;

d) kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

3. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për financat. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët. Ai emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve



administrativë të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

6. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjellja e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri përgjegjës për financat, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

7. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Agjencisë ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e Agjencisë ka elementet dhe formën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 725, datë 13.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 239, DATË 20.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KËRKESAT TEKNIKE DHE
FUNKSIONALE TË ZGJIDHJES
SOFTWARE-IKE PËR PROCEDURËN E
FATURIMIT DHE TË FISKALIZIMIT, SI
DHE PROCEDURËN E KRITERET PËR
REGJISTRIMIN E PRODHUESVE E TË
MIRËMBAJTËSVE TË ZGJIDHJEVE
SOFTWARE-IKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 239, datë 20.3.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “... procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të programeve ...” shtohen “, ... dhe procedurën e monitorimit të shoqërive, të certifikuara si prodhues dhe/ose mirëmbajtës të zgjidhjeve *software-ike*”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit e zgjidhjeve *software-ike*, pas certifikimit duhet të deklarojnë në platformën qendrore të faturave numrin real të bizneseve, pranë të cilave është instaluar *software-i*, të dhënat identifikuese për klientët, si dhe vlefshmërinë e kontratave të lidhura me ta. Prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit e zgjidhjeve *software-ike* përditësojnë në vazhdimësi këto të dhëna.”.

3. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, në fjalinë pas nënpikës “iv”, fjalët “... të paktën njërin nga ...” shfuqizohen.

b) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Të ketë të ardhura vjetore të tatueshme mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lek.”.

4. Në pikën 9 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë brenda fjalëve “... përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit, ...” hiqet fjala “... gjithë ...”;

b) Në shkronjën “a”. fjalët “... në më pak se ...” zëvendësohen me “... deri në ...”;

c) Në shkronjën “b”, fjalët “... por më pak se ...” zëvendësohen me “... dhe deri në ...”;

ç) Në shkronjën “c”, fjalët “... por më pak se ...” zëvendësohen me “... dhe deri në ...”.

5. Në pikën 10, fjalja e dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në këtë rast, të gjitha shoqëritë që marrin pjesë në bashkimin e operatorëve ekonomikë paraqesin dokumentet e kërkuara, sipas këtij vendimi, dhe vlerësimi i kriterëve kryhet për të gjithë pjesëmarrësit, me përjashtim të kërkesave të shkronjave “a”, “c” dhe “d”, të pikës 7, të cilat duhet të përmbushen minimalisht nga njëri prej pjesëmarrësve në bashkimin e operatorëve.”.

6. Në pikën 12, fjala “... ngarkojnë ...” zëvendësohet me fjalët “... depozitojnë pranë AKSHI-t ...”.

7. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Komisioni i certifikimit, pas marrjes së informacionit të ardhur nga komisioni i monitorimit, i ngritur sipas pikës 16.2, të këtij



vendimi, në rast se për operatorët prodhues/mirëmbajtës të zgjidhjeve *software*-ike të certifikuar kanë ndryshuar kriteret mbi bazën e të cilave janë certifikuar, vendos ricertifikimin e tyre, pasi të jetë rivlerësuar përmbushja e kërkesave, sipas kreut III, të këtij vendimi. Informacioni i përcjellë përmban të dhëna në lidhje me subjektin dhe kriteret konkrete që kanë ndryshuar, për të cilat nevojitet ricertifikimi i tij.”.

8. Pas pikës 16.1 shtohet pika 16.2, me këtë përmbajtje:

“16.2. AKSHI dhe DPT-ja, për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, me urdhër të përbashkët, ngrenë një komision të përhershëm me specialistë, sipas fushave të përkatësisë, të ndryshëm nga komisioni i ngritur sipas pikës 16, të këtij vendimi, i cili do t'i monitorojë prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit e zgjidhjeve *software*-ike, në mënyrë të detyrueshme, të paktën 1 (një) herë në vit, në bazë të analizës së riskut dhe sa herë konstatohet e nevojshme, bazuar në informacionet e marra. Ky komision shqyrton informacionet e ardhura nga strukturat e tjera në DPT apo tek AKSHI, nga palët e treta, si dhe nga ankesat e qytetarëve, në lidhje me shkeljet e kryera nga prodhuesit dhe/ose mirëmbajtësit e zgjidhjeve *software*-ike, duke kryer më tej monitorime apo kontrole për verifikimin e informacionit të marrë.”.

9. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Nëse komisioni i përhershëm, i ngritur sipas pikës 16.2, të këtij vendimi, konstaton se personi i certifikuar ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni për shkeljen e pretenduar, kryen verifikimet përkatëse, duke kërkuar të dhëna apo dokumente shtesë, sipas rastit edhe nga subjekti i certifikuar, ku është konstatuar shkelja, si dhe në çdo rast kërkon nga subjekti i certifikuar listën e tatimpaguesve, së bashku me të dhënat e kontaktit të tyre, të cilët kanë instaluar *software*-in e subjektit të certifikuar. Në përfundim të verifikimeve, komisioni harton një relacion sqarues dhe propozon masën përkatëse, të cilën ia përcjell titullarëve të AKSHI-t dhe DPT-së. Titullarët e AKSHI-t dhe DPT-së vendosin nëse do të shfuqizojnë ose jo certifikatën e dhënë. Vendimi për shfuqizimin e certifikatës, i marrë sipas kësaj pike, publikohet në një aneks të veçantë të regjistrit.

Subjektet e certifikuara gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Përgjegjësitë, detyrat, mënyra e monitorimit të prodhuesve dhe/ose mirëmbajtësve të zgjidhjeve *software*-ike, si dhe raportimi nga ana e komisionit të ngritur sipas pikës 16.2, të këtij vendimi, përcaktohen në mënyrë të hollësishme në rregulloren e përbashkët të AKSHI-t dhe DPT-së, të miratuar për këtë qëllim.”.

10. Pas pikës 21 shtohen pikat 21.1, 21.2, 21.3 dhe 21.4, me këtë përmbajtje:

“21.1. Konsiderohen shkelje të rënda, me pasojë revokimin e certifikatës, këto raste:

- Heqja, shtimi apo ndryshimi i elementeve në faturat e lëshuara nga *software*-et e certifikuara;

- Vënia në dispozicion apo hedhja në treg nga shoqëritë e certifikuara të *software*-eve të tjera të pacertifikuara;

- Mosdeklarimi real i numrit të bizneseve pranë të cilave është instaluar *software*-i;

- Mosdeklarimi real i klientëve, si dhe i vlefshmërisë së kontratave;

- Shoqëritë e certifikuara pas përfundimit të afatit të garancisë nuk e rinovojnë atë në mënyrë të përsëritur;

- Shoqëritë e certifikuara e instalojnë *software*-in në një numër më të madh biznesesh nga sa është vendosur garancia dhe nuk shtojnë vlerën e garancisë;

- Kur komisioni i monitorimit, bazuar në informacionet e ardhura nga burimet e ndryshme, pas kryerjes së verifikimeve përkatëse, konstaton shkelje me pasojë revokimin e certifikatës.

21.2. Çdo shkelje tjetër e dispozitave të këtij vendimi, që nuk përfshihet në përcaktimet e pikës 21.1 të këtij vendimi, konsiderohet shkelje e lehtë dhe, në këto raste, komisioni i ngritur sipas pikës 16.2 të këtij vendimi, paralajmëron shoqërinë e certifikuar se, në rast përsëritjeje, do të procedohet me revokimin e certifikatës. Gjithashtu, ky komision ia përcjell këtë informacion tatimpaguesve që rezultojnë se përdorin *software*-in e shoqërisë, tek e cila janë hasur problematika.

21.3. Në rastet kur komisioni i ngritur sipas pikës 16.2 të këtij vendimi, vendos revokimin e certifikatës, ky vendim hyn në fuqi pas kalimit të një afati 60-ditor (gjashtëdhjetëditor) nga e nesërmja e njoftimit të tij pranë shoqërisë (prodhuesit/mirëmbajtësit të zgjidhjes *software*-ike). Komisioni merr masa të menjëhershme për njoftimin e tatimpaguesve, të cilët rezultojnë se përdorin *software*-in e kësaj shoqërie, për t'u regjistruar pranë



një shoqërie tjetër të certifikuar. Brenda afatit 60-ditor (gjashtëdhjetëditor) këta tatimpagues duhet të regjistrohen pranë një shoqërie tjetër të certifikuar.

21.4. Pas revokimit të certifikatës, garancia e vendosur sipas parashikimeve të pikës 9, të këtij vendimi, ekzekutohet menjëherë nga DPT-ja. Tatimpaguesit e përmendur në pikën 21.3 të këtij vendimi, dëmshpërblehen nga DPT-ja deri në masën e garancisë së vendosur nga shoqëria, në përpjesëtim me numrin e bizneseve të regjistruara pranë saj. Procedurat dhe mënyrat e dëmshpërblimit, sipas kësaj pike, rregullohen me urdhër të titullarit të DPT-së. Në rastin e prodhuesve dhe të mirëmbajtësve të zgjidhjeve *software*-ike për përdorim vetjak, si dhe në rastin e bankave të certifikuara në cilësinë e prodhuesve dhe të mirëmbajtësve të zgjidhjeve *software*-ike për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike, garancia kalon në favor të DPT-së.”

II. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 726, datë 13.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 458, DATË 10.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FAKTORËVE DHE TË SITUATAVE QË MERREN PARASYSH NË VLERËSIMIN E RREZIQEVE TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4/2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4, të vendimit nr. 458, datë 10.6.2020, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Drejtoria e

Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 727, datë 13.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 538, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË DETAJUARA PËR NGRIRJEN E PËRKOHSHME TË FONDEVE APO TË PASURIVE TË TJERA TË PERSONAVE OSE ENTEVE TË SHPALLURA NGA STRUKTURAT PËRKATËSE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA APO ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, KU REPUBLIKA E SHQIPËRISË ËSHTË PALË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr. 538, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM

Nr. 728, datë 13.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
PËRDORIMIN E FONDIT TË
VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9 e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Përfshihet, për vitin 2023, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njësit të fondeve speciale, institucioneve publike të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, në varësi të institucioneve qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve.”.

2. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 730, datë 13.12.2023

**PËR DEKLARIMIN PASURI
KULTURORE E PALUAJTSHME E
ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B”
TË QYTETIT TË SARANDËS, “KALASË
SË LËKURËSIT” E “MANASTIRIT TË 40
SHENJTORËVE”, DHE MIRATIMIN E
ZONIMIT E TË PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, dhe të dhe nënparagrafit “iv”, të pikës 3/b, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, “Kalasë së Lëkurësit” e “Manastirit të 40 Shenjtorëve”.

2. Miratimin e zonimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, “Kalasë së Lëkurësit” dhe “Manastirit të 40 Shenjtorëve”, sipas koordinatave dhe hartave të zonimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 428, datë 20.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe aktet nënligjore në fuqi.

6. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës në Gjeoportalin Kombëtar.

7. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E ZONAVE
ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË
QYTETIT TË SARANDËS, “KALASË SË
LËKURËSIT” DHE “MANASTIRIT TË 40
SHENJTORËVE”

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, “Kalasë së Lëkurësit” dhe “Manastirit të 40 Shenjtorëve”, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 2
Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”, përbëhet nga:

- a) Zona Arkeologjike “A” e qytetit të Sarandës;
- b) Zona Arkeologjike “B” e qytetit të Sarandës;
- c) Zona Arkeologjike “A” e “Kalasë së Lëkurësit”;
- ç) Zona Arkeologjike “B” e “Kalasë së Lëkurësit”;
- d) Zona Arkeologjike “A” e “Manastirit të 40 Shenjtorëve”;
- dh) Zona Arkeologjike “B” e “Manastirit të 40 Shenjtorëve”.

2. Kufijtë e zonave arkeologjike “A” dhe “B” paraqiten në hartat e zonimit të qytetit të Sarandës, “Kalasë së Lëkurësit” dhe “Manastirit të 40 Shenjtorëve”, me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar-KRGJSH, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Hartimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit urban të qytetit të Sarandës merr në konsideratë kufijtë e zonimit të zonave arkeologjike

“A” dhe “B, të qytetit të Sarandës”, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

Neni 3

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike
“A” të qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit”
dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”

1. Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve” lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në vijim “KKTKM”;

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse për miratimin e projekteve kërkimore-shkencore pranë Akademisë së Shkencave, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe i të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cenon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta të përkohshme (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.



2. Projekti për strukturat e përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni, miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe plan-projektin e saj. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Sarandës “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”

1. Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe ndërtimet e reja pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes të formave të testimit, të përcaktuara nga KKTKM-ja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona.

4. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës, “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pas aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit.

Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në vijim “IKTK”.

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

6. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda kufirit të zonave arkeologjike “A” dhe “B”, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuar shprehimisht në ligj.

Neni 6

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Sarandës “Kalaja e Lëkurësit” dhe “Manastiri i 40 Shenjtorëve”

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda zonave arkeologjike “A” dhe “B”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) për qytetin e Sarandës ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.



2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Sarandës, njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet menjëherë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Sarandës, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145,

146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonat arkeologjike “A” dhe “B” lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.


3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmimeve dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Sarandës, pas njoftimit zyrtar nga Bashkia Sarandë.

4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 9


Trajtimi i rasteve të paparashikuara


Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.
















Zonat arkeologjike te Manastirit te 40 Shenjtoreve
Koordinata ne sistemin KRGJSH

Zona arkeologjike A

No.	E	N
1	501806.26	4415402.81
2	501832.53	4415405.7
3	501864.73	4415414.99
4	501893.11	4415413.52
5	501904.54	4415385.94
6	501913.03	4415355.7
7	501916.21	4415329.19
8	501917.47	4415309.92
9	501903.59	4415287.99
10	501884.65	4415276.88
11	501874.85	4415273.71
12	501847.78	4415275.39
13	501835.23	4415280.2
14	501828.88	4415290.28
15	501814.79	4415318.51
16	501804.71	4415349.87
17	501807.93	4415379.22

Zona arkeologjike B

No.	E	N
1	501452.15	4415435.06
2	501529.9	4415544.17
3	501572.25	4415582.71
4	501601.74	4415610.01
5	501614.29	4415676.62
6	501654.8	4415708.63
7	501668.05	4415707.61
8	501751.17	4415635.65
9	501822.57	4415574.93
10	501871.62	4415518.96
11	501961.03	4415397.39



12	502039.06	4415272.14
13	502069.72	4415239.66
14	502073.4	4415219.03
15	502065.42	4415193.55
16	502049.84	4415177.12
17	502032.29	4415160.51
18	501934.94	4415160.09
19	501888.93	4415153.25
20	501836.85	4415154.75
21	501803.86	4415173.65
22	501725.8	4415251.77
23	501707.64	4415278.93
24	501627.52	4415332.46
25	501599.38	4415359.76
26	501578.66	4415371.52
27	501546.5	4415382.81
28	501512.23	4415400.08
29	501484.42	4415418.89



Zonat arkeologjike te qytetit te Sarandes
Koordinata ne sistemin koordinativ KRGJSH

Zona Arkeologjike "A"

No.	N	E
1	4415450.5	500338.3
2	4415652.808	500359
3	4415708.75	500361.1
4	4415752.52	500538.2
5	4415674.174	500569.9
6	4415594.01	500603.7
7	4415521.7	500632.6
8	4415494.64	500639.5
9	4415485.96	500629.1
10	4415472.15	500595.8
11	4415417.29	500415.8
12	4415407.45	500406.8
13	4415396.81	500360.1
14	4415400.36	500332.9

Zona Arkeologjike "B"

No.	N	E
1	4415397.75	500326.6
2	4415390.94	500290.6
3	4415378.15	500278.4
4	4415373.95	500208.1
5	4415415.11	500207
6	4415440.78	500194.1
7	4415454.64	500171.8
8	4415473.84	500111.2
9	4415488.73	500056.8
10	4415489.57	500031.1
11	4415487.05	500008.5
12	4415499.55	500008.7
13	4415511.31	500047.7
14	4415528.67	500077.8
15	4415547.48	500102.1
16	4415565.73	500128.5



17	4415580.1	500135.5
18	4415601.15	500143.8
19	4415636.43	500141.2
20	4415660.27	500151.1
21	4415674.74	500164.3
22	4415699.05	500191.9
23	4415712.26	500189.8
24	4415730.55	500189.8
25	4415732.6	500205.6
26	4415736.15	500222.3
27	4415746.04	500235.3
28	4415752.58	500253.2
29	4415813.2	500258.6
30	4415807.83	500350.2
31	4415869.55	500501.2
32	4415885.69	500519.5
33	4415870.9	500544.7
34	4415824.93	500626.9
35	4415814.34	500630
36	4415757.7	500635.7
37	4415748.56	500690.9
38	4415740.11	500736
39	4415687.28	500848.6
40	4415623.89	500971.1
41	4415605.22	500995
42	4415538.03	501048.4
43	4415506.81	501082.8
44	4415489.78	501114
45	4415470.6	501151.7
46	4415446.89	501143.5
47	4415427.43	501174.3
48	4415389.02	501169.5
49	4415315.59	501174.7
50	4415307.28	501160.9
51	4415372.19	501122.4
52	4415427.47	501092.2
53	4415456.17	501051.3
54	4415475.45	501005.4
55	4415481.33	500973.2
56	4415484.08	500915.4
57	4415497.8	500856.9
58	4415517.31	500790.2
59	4415527.39	500775.8
60	4415525.43	500731.5
61	4415520.76	500695.7
62	4415507.23	500657.9
63	4415489.49	500645.4
64	4415473.44	500612.4
65	4415413.07	500414.8
66	4415405.13	500406.9
67	4415392.72	500355.6



Zonat Arkeologjike te Kalase se Lekursit
Koordinata ne sistemin koordinatin KRGJSH

Zona Arkeologjike A

No.	E	N
1	502356.9	4414653.54
2	502322.55	4414673.28
3	502287.55	4414691.48
4	502243.87	4414705.3
5	502184.65	4414706.37
6	502154.13	4414699.65
7	502138.55	4414690.6
8	502126.41	4414675.2
9	502126.79	4414652.14
10	502129.03	4414632.08
11	502139.48	4414604.08
12	502163.56	4414594.65
13	502233.19	4414576.17
14	502289.7	4414556.38
15	502329.09	4414557.04
16	502355.87	4414573.37
17	502359.14	4414613.08

Zona Arkeologjike B

No.	E	N
1	502384.95	4414721.37
2	502345	4414751.52
3	502299.59	4414759.73
4	502219.4	4414767.06
5	502130.31	4414754.74
6	502091.3	4414729.63
7	502095.92	4414678.78
8	502099.38	4414646.4
9	502122.06	4414585.08
10	502155.42	4414528.75
11	502189.82	4414473.59
12	502225.8	4414411.38
13	502253.98	4414327.29
14	502276.2	4414260.53



15	502314.34	4414134.12
16	502367.54	4414003.55
17	502409.92	4413896.68
18	502426.67	4413852.07
19	502481.22	4413818
20	502515.29	4413831.25
21	502551.83	4413901.44
22	502580.11	4414020.11
23	502570.36	4414105.14
24	502548.98	4414193.71
25	502533.49	4414320.83
26	502520.24	4414389.67
27	502455.65	4414501.32
28	502407.58	4414663.86

VENDIM**Nr. 734, datë 13.12.2023**

**PËR NGARKIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI
AUTORITET KONTRAKTOR, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS
MULTIFUNKSIONALE PËRRETH
KOMPLEKSIT TË STADIUMIT
“FLAMURTARI” NË VLORE,
PËRFSHIRË STADIUMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për zbatimin e projektit, për zhvillimin e zonës multifunkionale përreth kompleksit të stadiumit “Flamurtari” në Vlorë, përfshirë stadiumin.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre dhe të projektit përkatës, duke përdorur fonde nga programet aktuale të zhvillimit;

b) paraqitjen e kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit kompetent të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e të procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e territorit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Vlorë lidhin marrëveshje bashkëpunimi, në funksion të zhvillimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Vlorë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**URDHËR
Nr. 680, datë 12.12.2023**

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të



pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për datat 13.12.2023 deri më 14.12.2023, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM

Nr. 724, datë 7.12.2023

PËR RINDARJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “d” dhe “ë”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në shkronjën “d”, të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 4, të nenit 94, dhe shkronjën “c”, pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rasteve dhe kriterëve për rindarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë në kuptim të termit “Seksion” edhe Kolegjet e Gjykatës së Lartë.

Neni 2
Qëllimi

Rindarja me short e çështjeve gjyqësore ka për qëllim caktimin e gjyqtarit të ri relator në gjykimin e një çështjeje gjyqësore, si në rast kur ai gjykon i vetëm ashtu edhe kur gjykon në trup gjykues kolegjial. Rregullat për formimin e mëtejshëm të trupit gjykues përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 3
Parimet

Rindarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të procesit të rregullt ligjor, transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes, eficiencës dhe objektivitetit.

Neni 4
Mënyra e rindarjes së çështjeve me short

Rindarja e çështjeve me short kryhet vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe i nënshtrohet të njëjtave rregulla të parashikuara në kreun II, të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022, “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 5
Rastet e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore

1. Çështjet rindahen me short në rastet e mëposhtme:

a) për shkak të miratimit të dorëheqjes ose vendimit të përjashtimit të gjyqtarit, sipas ligjit;

b) për shkak të mbarimit të statusit të gjyqtarit, sipas ligjit;

c) për shkak të caktimit të përkohshëm, komandimit, transferimit ose ngritjes në detyrë sipas përcaktimeve të vendimit të KLGJ-së, sipas ligjit;

ç) kur zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit;

d) për shkak të pezullimit përkohësisht nga detyra për shkak të ligjit, me vendim të KLGJ-së, sipas ligjit;



dh) nuk paraqitet përkohësisht në detyrë për arsye që lidhen me:

i. paaftësinë shëndetësore gjatë periudhës së përfitimit të mbrojtjes së detyrueshme nga sigurimet shoqërore;

ii. përfitimin e lejes së papaguar;

iii. përfitimin e lejes së veçantë;

e) kur pozicioni i magistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative;

ë) për shkak të riorganizimit gjyqësor e suprimimit të gjykatës;

f) për shkak të riorganizimit të brendshëm të gjykatës, përmes:

g) krijimit të seksioneve të reja;

ii. shtimit ose pakësimit të trupave gjykuese në një seksion;

iii. caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër.

gj) shtimi i gjyqtarëve në gjykatë.

2. Nuk rindahen me short çështjet urgjente për të cilat, çdo fillim viti, kryetari i gjykatës, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar listën e gjyqtarëve për gjykimin e tyre. Rindarja e këtyre çështjeve bëhet sipas aktit të kryetarit të gjykatës, i nxjerrë në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Kryetarët e gjykatave, në çdo rast tjetër, tej atyre të përcaktuara në këtë vendim, kur vlerësojnë se zgjidhja e një situate konkrete që ka të bëjë me eficiencën e drejtësisë mund të bëhet vetëm përmes rindarjes me short të çështjeve gjyqësore, duhet të informojnë menjëherë Këshillin e Lartë Gjyqësor për të vlerësuar nëse ajo situatë përbën një rast nevojë që justifikon rindarjen me short të çështjeve gjyqësore.

Neni 6

Kriteret për rindarjen me short të çështjeve, për rrethana që kanë të bëjnë me gjyqtarin të cilit i janë caktuar

1. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për shkak të ndërprerjes së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të cilit i janë caktuar, rindahen me short menjëherë pas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për deklarimin e mbarimit të statusit të magistratit për këtë gjyqtar.

2. Rindarja e çështjeve me short, në rastin e gjyqtarit që ndërpret përkohësisht ushtrimin e funksionit, është përgjegjësi e kryetarit të gjykatës. Në këtë rast, kryetari i gjykatës vlerëson shkakun konkret të lindur për rindarjen e çështjeve me short, shkallën e urgjencës së çështjeve, fazën e gjykimit të tyre, si edhe kohën ose pritshmëritë për rifillimin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të cilit i janë caktuar. Bazuar në rrethana të njohura apo në informacionet e marra nga autoritetet përkatëse, kryetari i gjykatës, nëpërmjet një akti të motivuar, mund të urdhërojë rindarjen e të gjitha çështjeve të atij gjyqtari apo të një pjese apo kategorie të caktuar të tyre, si dhe për kohën e rindarjes me short të çështjeve.

3. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për shkak të ndërprerjes, përkohësisht ose përfundimisht, të ushtrimit të funksionit në atë gjykatë të gjyqtarit të cilit i janë caktuar, rindahen me short menjëherë me konfirmimin e shkakut të rindarjes së çështjeve.

4. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si gjyqtar i vetëm, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

5. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, ndërsa shkak i rindarjes lind përpara fillimit të gjykimit ose përpara shpalljes së tyre për gjykim, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit përkatës të gjykatës dhe kur kjo nuk është e mundur, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të gjykatës.

6. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre, në rastin kur ato i janë caktuar gjyqtarit si relator në një trup gjykues kolegjal, ndërsa shkak i rindarjes lind gjatë gjykimit të tyre ose kur çështjet janë shpallur për gjykim, rindahen me short për përcaktimin e relatorit ndërmjet anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, i cili më pas plotësohet me një anëtar tjetër.



Neni 7

**Kriteret për rindarjen me short të
çështjeve për rrethana që kanë të bëjnë me
gjykatën ku janë regjistruar**

1. Çështjet e ndara me short, për të cilat bëhet e nevojshme rindarja e tyre për rrethana që kanë të bëjnë me gjykatën ku janë regjistruar, rindahen me short menjëherë me konfirmimin e shkakut të rindarjes së çështjeve, si dhe në varësi të shkakut konkret të rindarjes.

2. Në rastin e suprimimit të gjykatës për shkak të riorganizimit gjyqësor, çështjet rindahen me short pas regjistrimit të tyre në gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore. Nëse gjyqtari i gjykatës së suprimuar caktohet në gjykatën që përcaktohet si kompetente nga pikëpamja tokësore, çështjet e caktuara atij më parë me short nuk rindahen, por i kalojnë këtij gjyqtari.

3. Në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, çështjet që i përkasin këtyre seksioneve rindahen me short me krijimin e tyre. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave nuk ka filluar për gjykatat e shkallës së parë apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, si dhe për përcaktimin e çështjeve të regjistruara më parë që do të rishortohen.

4. Në rastin e shtimit të trupave gjyquese në një seksion të gjykatës, çështjet e seksionit ku shtohen trupat gjykues rindahen me short me krijimin e trupave të reja gjyquese. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të trupave gjyquese në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e caktuar rishtazi në një seksion të gjykatës, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të këtij seksioni, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme.

5. Në rastin e pakësimit të trupave gjyquese në një seksion të gjykatës, çështjet e gjyqtarëve të trupave gjyquese të pakësuara, me daljen e vendimit përkatës të këshillit të gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të këtij seksioni. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e pakësimit të trupave gjyquese në një seksion të gjykatës, si dhe për përcaktimin e çështjeve që do të rishortohen.

6. Në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, çështjet e këtij gjyqtari, me caktimin e tij në një seksion tjetër nga këshilli i gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit ku ky gjyqtar bënte pjesë. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarin e caktuar rishtazi në një seksion tjetër, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit ku caktohet, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme.

7. Në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, çështjet e gjykatës dhe kur është rasti ato që i përkasin seksionit ku gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen, rindahen me short menjëherë dhe, kur është rasti, me caktimin e këtyre gjyqtarëve në seksione. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar apo ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat më të larta. Gjyqtarët e ardhur rishtazi, përmes rindarjes me short të çështjeve, ngarkohet me një numër çështjesh jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate apo, kur është rasti, se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit përkatës të gjykatës në të cilin gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të



çështjeve në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e ardhur rishtazi në gjykatë, për aq sa është e mundur, të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë.

Neni 8

Zbatimi i vendimit

1. Ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e procedurave dhe zhvillimeve të nevojshme në sistemin e menaxhimit të çështjeve, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë